



**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE
TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË SHKOLLAVE ME DREJTIM TË ORIENTUAR
ARTISTIK
DEGA "MUZIKË"**



Program orientues

**Koordinator:
Marina Topulli**

2024-2025



TABELA E PËRMBAJTJES


TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE.....	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar.....	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU	14
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	21
Model ore mësimore për degën “Muzikë”, AML.....	22
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	32
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	40
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML	42
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML	48

HYRJE

Roli i mësuesit shtrihet përtej mësimdhënies dhe në veçanti roli i mësuesit të muzikës është edhe më i rëndësishëm për shkak të natyrës sfiduese të kësaj fushe. Ai ndikon në krijimin e një mjedisi pozitiv mësimor, zhvillimin e mendimit kritik dhe nxitjen e motivimit për të mësuar. Mësuesit që përdorin teknika efektive mësimore, të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, arrijnë të maksimizojnë potencialin e çdo nxënësi. Një marrëdhënie e mirë mes mësuesit dhe nxënësit krijon një ndjenjë sigurie dhe përkatësie që rrit motivimin dhe angazhimin në mësim. Mësuesit që janë të aftë të identifikojnë vështirësitë individuale dhe t'u japin mbështetje të personalizuar nxënësve, ndikojnë ndjeshëm në arritjet e tyre akademike. Mësuesit shpesh janë shembuj për nxënësit, duke ndikuar jo vetëm në njohuritë mësimore, por edhe në vlerat dhe sjelljet që ata përvetësojnë.

Muzika kërkon të menduarit kritik për zgjidhjen e problemeve dhe analizimin e situatave komplekse. Një mësues i aftë mund t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të menduar logjikisht dhe për të zbërthyer problemet në hapa të qartë. Mësuesi duhet të jetë i aftë të përdorë metoda të ndryshme për të shpjeguar konceptet e vështira. Kjo mund të përfshijë përdorimin e mjeteve vizuale, shembujve praktikë, dëgjimeve muzikore apo aplikimeve në jetën reale që i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet muzikore. Muzika ndërtohet mbi konceptet e mëparshme. Një mësues i mirë i muzikës e di se duhet të fillojë nga bazat dhe të krijojë një strukturë logjike për të avancuar me koncepte më të përparuara. Kjo siguron që nxënësit të kenë një themel të fortë dhe të mos ndihen të mbingarkuar. Një mësues i mirë i muzikës mund të identifikojë nxënësit që kanë vështirësi në fusha të caktuara dhe të japë mbështetje shtesë për ta.

Shpesh muzika shihet si lëndë që duhet të zhvillohet vetëm me nxënësit e talentuar. Mësuesi duhet të krijojë aktivitete dhe sfida që nxisin kureshtjen e nxënësve, duke e lidhur muzikën me situata praktike nga jeta e përditshme ose me fushat që ata i pëlqejnë. Mësuesi i muzikës mund të përfitojë nga përdorimi i programeve kompjuterike, aplikacioneve dhe platformave edukative që ndihmojnë nxënësit të praktikojnë konceptet dhe të zgjidhin vështirësitë me muzikën.



Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtrë”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së muzikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së muzikës për zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet global që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore, sigurisë kibernetike etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar; të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për degën e muzikës në nivelin arsimor : *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizimin e orës së hapur mësimore, dy modele orësh mësimore për degën e muzikës në nivelin arsimor *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektsh kurrikulare për degën e muzikës në nivelin arsimor *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Programe ose specialitete për degën e muzikës;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të programeve ose specialiteteve për degën e muzikës;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve ose specialiteteve për degën e muzikës.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale artistike si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave artistike të programeve ose specialiteteve për degën e muzikës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME/SPECIALITETE DEGA MUZIKË”

Kompetenca

“Zbatimi në mënyrë efektive i kurrikulës në arsimin me drejtim të orientuar artistik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:

- zbaton programin e kurrikulës në *degën* dhe *specialitetin* përkatës dhe si zbatohet ajo në shkollë;
- përshtat programin lëndor në përputhje me ecurinë teknike të nxënësit sipas klasave;
- përdor me efikasitet, në dobi të pririjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;
- gjen ose harton materiale plotësuese artistike që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;
- gjen ose harton materiale plotësuese artistike që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre ndaj artit;
- harton rezultate të nxëni për lëndën/specialitetin, për tema mësimore ose grup temash, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit dhe nivelit të nxënësit;
- kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;
- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve në *degën* dhe *specialitetin* përkatës);

- Korniza kurrikulare 2014.
- Kurrikula e shkollave artistike, miratuar nga MASR-ja, Tiranë, 2024.
- Qëllimet e arsimit me drejtim të orientuar artistik, (sipas degës).
- Programet e përgjithshme të lëndëve: *teorike-artistike*.
- Programet e lëndëve: *praktike-artistike*.
- Programet e lëndës së *specialitetit*.
- Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat X-XII.

- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit në *degën* dhe *specialitetin* përkatës;
- siguron informacion që demonstroi lidhjen e *specialitetit* përkatës me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin me drejtim të orientuar artistik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:

- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;
- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;
- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;
- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj *artëve* dhe *specialitetit* që përfaqëson/drejton;
- identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.
- Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit të shkollave me drejtim të orientuar artistik me nxënësit e tij.

- identifikon nxënësit me prirje të veçanta jo vetëm në zhanrin klasik por edhe në zhanre të tjera;
- planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;
- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj arteve dhe specialitetit;
- edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës/specialitetit;
- motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;
- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;
- punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e e *specialitetit/lëndës* në arsimin me drejtim të orientuar artistik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:

- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar në degën ku ai zhvillon specialitetin/lëndën;
- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;
- planifikon orën mësimore, bazuar mbi metodë artistike specifike të specialitetit;
- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimit mesëm), ASCAP.
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së muzikës në arsimin e mesëm të lartë.

- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;
- përdor proceset artistike në mësimdhënien – nxënien e muzikës;
- demonstroi teknika/forma të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;
- shpjegon parimet e parimet e ngritjes së komisioneve vlerësuese si: kontroll teknik/saxho .

Kompetenca III

“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies, në arsimin me drejtim të orientuar artistik”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:

- prezanton materialet apo dokumentet e veta lidhur me lëndët teorike/praktike artistike, duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Finale, Design, Type në Word etj.;
- nxit nxënësit të bëjnë prezantime në lëndët artistike duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;
- gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënien nxënien;
- përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndëve të ndryshme artistike apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website.

- Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
- Udhëzues për mësimin e muzikës (për klasat X-XII të arsimit të mesëm të lartë) (modele orësh mësimore dhe veprimtari praktike) ASCAP.

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca	Literatura
<p align="center">“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca	Literatura
<p align="center">“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe; 	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca

“Respektimi i rigozitetit shkencor në mësimdhënien dega muzikë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i shkollave me drejtim të orientuar artistik:

- dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e muzikës në klasat VI-IX;
- përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve muzikore në klasat VI-IX;
- përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehjeve;
- dallon ndërvarësinë e koncepteve muzikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;
- zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme muzikore të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat X-XII;
- përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të muzikës në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.

- Programe dhe tekste të lëndës së muzikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X-XII për arsimin e mesëm të lartë.

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU

Model pyetjesh të lëndës “Muzikë”, AMU

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Cila nga alternativat e mëposhtme **NUK** ka të bëjë me zhvillimin e *kompetencave profesionale artistike* të nxënësit në përfundim të arsimimit në degën Muzikë.

- A) Përdorin burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve artistike, të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik.
- B) Nxisin potencialin e tyre të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë në fushën e artit dhe të muzikës.
- C) Angazhohen fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin artistik, personal dhe shoqëror.
- D) Zhvillojnë ekspedita kërkimore mbi artin nëpër zona.

Pyetja 2

Njohuritë në kurrikulën e muzikës përcaktohen për secilën lëndë dhe specialitet përmes një dokumenti që miratohet nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Specialitetet p.sh: violinë, piano, violonçel planifikohen të zhvillohen nga çdo mësues në:

- A) Një periudhë
- B) Dy periudha
- C) Tre periudha
- D) Katër periudha.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetje 3

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Gjatë një ore mësimi, mësuesi u drejton nxënësve pyetjen “Gjykoni veprën muzikore përmes dëgjimit duke renditur karakteristikat dhe cilësitë e saj”. Kjo kërkesë zhvillon të shprehurit e mendimit në mënyrë:

- A) interpretuese;
- B) analizuese;
- C) krahasuese;
- D) vlerësuese.

Pyetje 4

Rezultatet që doni të arrini me nxënësit gjatë punës tuaj në ndërtimin e kompetencave artistike me ta, zhvillohet vetëm përmes:

- A) njohurive artistike;
- B) aftësive artistike;
- C) qëndrimeve ndaj artit;
- D) njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.

Pyetja 5

Vlerësimi formues në shkollat artistike kryhet:

- A) gjatë gjithë kohës;
- B) në fillim të vitit shkollor;
- C) në përfundim të një periudhe;
- D) në përfundim të një kohe të caktuar.

Pyetja 6

Baza e një planifikimi të suksesshëm është:

- A) njohja dhe zbatimi me përpikmëri i të gjitha kërkesave të programit mësimor;
- B) hartimi i rezultateve të të nxënësve që janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit;
- C) përzgjedhja e metodave dhe strategjive më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit;
- D) të tria sa më sipër.

Pyetja 7

Çdo veprimtari mësimore që mësuesi planifikon të përdorë në klasë, gjatë një ore mësimi, duhet të synojë të paktën:

- A) Organizimin e nxënësve në klasë.
- B) Zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të ulët.
- C) Zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë.
- D) Një nga objektivat/RN e mësimit.

Pyetja 8

Qarko përgjigjen e saktë.

Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formues dhe është:

- A) vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të mësuarit;
- B) vlerësim që mbledh prova që tregojnë nëse mësuesdhënia ka realizuar qëllimin e saj;
- C) vlerësim që mbledh të dhëna për suksesin e orës së mësimit;
- D) vlerësim përmbledhës që kryhet në fund të periudhës.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 9

Mësuesi ka planifikuar një vizitë me nxënësit në bibliotekën e qytetit. Çfarë është më efektive të bëjë mësuesi, në mënyrë që edhe Joni, një fëmijë që lëviz me anë të karrocës, ta vizitojë bibliotekën?

- A) Mësuesja i kërkon një mësuesi tjetër për ta shoqëruar Jonin në këtë vizitë.
- B) Mësuesja shkon më parë në bibliotekë dhe evidenton problemet me të cilat mund të ndeshet nxënësi i saj dhe bën një planifikim paraprak.
- C) Mësuesja i kërkon Jonit të vijë i shoqëruar me një pjesëtar të familjes, i cili do ta shoqërojë atë.
- D) Mësuesja e inkurajon dhe i kërkon Jonit të qëndrojë në shtëpi ditën e vizitës.

Pyetja 10

Për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasat e zakonshme, mësuesi ndihmës bën vlerësimin sipas niveleve të arritjeve të fushave të zhvillimit të përcaktuara në PEI. Ky vlerësim duhet bërë në bashkëpunim:

- A) me drejtuesin e institucionit arsimor dhe specialistë të patologjisë/ve që shfaq fëmija;
- B) me mësuesin e lëndës dhe shërbimin psiko-social të institucionit arsimor;
- C) me prindin dhe kujdestarët që kujdesen për fëmijën;
- D) me komisionin multidisiplinar të ngritur pranë ZVAP-së.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) klasat 9-ta të shkollës
- B) klasat e 9 të shkollës
- C) klasat e 9-ta të shkollës
- D) klasat e 9-të të shkollës

Pyetja 12

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.

- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 13

Muzika e baletëve shqiptare “Cuca e maleve dhe Gjenerali i ushtrisë së vdekur” u kompozuan nga:

- A) Feim Ibrahimi
- B) Nikolla Zoraqi
- C) Kozma Lara
- D) Shpëtim Kushta

Pyetja 14

Poemi simfonik i titulluar “Tasso “ u kompozua nga:

- A) H.Berlioz
- B) F. List
- C) F.Shopen
- D) F. Mendelson

Pyetja 15

Cikli simfonik me katër kohë u përcaktua nga:

- A) Moxart
- B) Hajden
- C) Bethoven
- D) List



Pyetja 16

Reformatori i operas *seria* Kristof Vilibald Gluk çoi më tej parimet e:

- A) Klaudio Monteverdit
- B) Zhan Batist Lyli
- C) Henri Persell
- D) Reinhard Kajzeri

Pyetja 17

Periudha në të cilën filloi të vendosej emri i kompozitorit në vepër ishte:

- A) Mesjeta
- B) Rilindja
- C) Antikiteti
- D) Baroku

Pyetja 18

Elemente muzikore popullore të Lindjes përfshihen në krijimet e kompozitorit:

- A) Alban Berg
- B) Samuel Barber
- C) Béla Bartók
- D) Pierre Boulez

Pyetja 19

Gjatë periudhës Barok, interesi i ringjallur për dramën greke kontribuoi në zhvillimin e formave të mëposhtme muzikore si:

- A) Oratorio
- B) Villanella
- C) Opera
- D) Singspiel

Pyetja 20

Artet me ndërmjetësi muzikore i përkasin periudhës së:

- A) Mesjetës
- B) Antikitetit
- C) Rilindjes
- D) Barokut

Pyetja 21

Instrumenti i perkusionit pa *lartësi tingulli* është:

- A) cajon
- B) snare drum
- C) timpani
- D) cimbali

Pyetja 22

Cili prej pohimeve *nuk* është i saktë:

- A) Në shekullin XVIII lindja operas “*bufo*” dhe “*seria*” erdhi si rrjedhim i gjendjes së re shoqërore politike që ishte krijuar në Evropë.
- B) Në shekullin XVIII nga opera kërkohet trajtimi dhe pasqyrimi me vërtetësi i ngjarjeve të jetës së përditshme.
- C) Në shekullin XVIII kërkohet që në opera të pasqyrohet heroikja tragjika dhe dramat e jetës.
- D) Në shekullin XVIII kërkohet që në opera të pasqyroheshin tiparet kombëtare .

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës sesi ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve dhe nevojat e nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat artistike janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Më poshtë janë paraqitur tre modele orësh mësimore për degën e muzikës në nivelet arsimore *AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për degën “Muzikë”, AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënit, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore 1 - Dega e “Muzikës” AML

Fusha: Arte	Lënda: Histori Muzike	Klasa: 10 /12-të
Tema mësimore: “Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit”		Situata e të nxënit: Vepra dhe kompozitorë Vendosen disa fjalë kyçe që përkojnë me ngjarje të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore .
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none">• Shpjegon ngjarjet historike, artistike, ekonomike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit.• Shpjegon rrishtë e periudhës dhe zhvillimet e mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën).• Argumenton duke krahasuar një vepër të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës barok, duke renditur disa karakteristika.• Krijon linjën e kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">• Klasicizëm• Opera seria• opera bufa• simfonia• sonata• trio

<p>ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit duke e prezantuar në klasë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respekton mendimin e shokëve. 	
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teksti i nxënësit. • Shembuj muzikorë të parapërgatitura në Cd. • foto ose materiale të tjera. 	<p>Lidhja me lëndët e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Letërsia • Historia • Arti
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p><i>Hapi I. Brainstorming :</i> Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi shkruan disa fjalë kyçe që përkojnë me ngjarje të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore p.sh.: në Cd <i>kohën e parë e simfonisë – molto allegro, cd.</i></p> <p><i>Hapi II. Teknika Pro dhe Kundër:</i></p> <p>Pasi nxënësit e dëgjojnë nxiten të diskutojnë rreth muzikës që dëgjuan, muzikë e cila nga vetë karakteri është mjaft allegro si melodi. Bëhen disa pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Si e përjetoni ju melodinë? • Dinamikat përgjatë melodisë janë forte-piano? • Tingëllimi shumë i shpejtë i tingujve që herë ngjiten lart dhe herë zbresin poshtë. <p><i>Hapi III. Teknika Tabela e koncepteve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësuesi shpjegon rreth zhvillimeve muzikore gjatë kësaj periudhe. Gjysma e dytë e shek. XVIII njohu një revolucion të vërtetë të mendimit dhe të ideve. Kjo lëvizje me emrin <i>iluminizëm</i> (ndriçoi) nuk lindi rastësisht, por i pati rrënjët në ndryshimet ekonomiko-shoqërore që ndodhën si pasojë e 	

revolucioneve borgjeze, veçanërisht të Revolucionit Borgjez Francez (1789) dhe të Revolucionit Amerikan (luftës për pavarësi 1776–1783).

Iluminizmi kishte si qëllim të ndriçonte mendjen e njerëzve për t'u larguar nga injoranca dhe besëtytnitë dhe për t'i kthyer sytë nga shkenca dhe kultura. Zbulimet e mëdha shkencore dhe përmbajtja revolucionare e ideve iluministe u bënë mbështetje e fuqishme edhe për shndërrimet në fushat shoqërore. Karakteristika kryesore të lëvizjes ideo-artistike të kësaj periudhe në Evropë është shprehja e gjendjes shpirtërore zotëruese të epokës; e zhgënjimit dhe e pakënaqësisë ndaj realitetit ekzistues.

Format dhe mënyrat e shprehjes së kësaj pakënaqësie ishin të larmishme. Ato merrnin karakter dhe drejtime të ndryshme. Pikërisht për këto arsye dhe për të tjera, të cilat lidhen me gjithë lëvizjen shoqërore të kohës, kjo pjesë e shekullit do të mbyllet me periudhën e klasicizmit në muzikë, periudhë në të cilën arti muzikor fitoi tipare të reja, duke u ndarë nga stili i ngarkuar dhe plot fantazi i barokut.

Kulmin e saj madhështor periudha klasike e arriti me perfeksionimin e *simfonisë* në formë dhe përmbajtje, si dhe me lindjen e një koncepti të ri e të madh muzikor siç ishte forma e *sonatës klasike*.

etj...



Hapi IV: Reflektimi

Diskutim përmbledhës

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- N 2 - lidhjen e njohurive që ka me ngjarjet historike, artistike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit.
- N 3 - Shpjegimin e risive të periudhës dhe zhvillimeve të mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën).
- N4 - Krahasimin e një vepre muzikore të së njëjtës lloj të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës Barok, duke renditur disa karakteristika.
- N 4 - Prezantimin e ngjarjeve të kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit.

Detyra:

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme (foto, piktura, dokumente historike) për të zgjeruar më tej njohuritë rreth karakteristikave të kësaj periudhe, duke u ndalur tek momentet që bënë jehonë.

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme për të zgjeruar më tej njohuritë biografike dhe muzikore rreth përfaqësuesve të muzikës klasike dhe veprave që ata kompozuan. Krijoni album në cd me muzikën e kësaj periudhe.

Ese: Duke dëgjuar një veprat muzikore të L.V.Bethovenit apo V.A.Moxart përshkruani përjetimin tuaj emocional rreth muzikës së dëgjuar.

Model ore mësimore 2 - Dega e “Muzikës” AML

Fusha: Arte	Lënda: Histori Muzike	Klasa: 10/12-të
Tema mësimore: “Muzika moderne”		Situata e të nxënit: Rryma që unë pëlqej më shumë Vendosen disa fjalët kyçe apo disa pjesë/këngë për tu dëgjuar në cd, që shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth zhvillimit të muzikës moderne përmes rrymave dhe stileve të ndryshme gjatë shekullit 20-të. Ata nxiten për diskutime bazuar edhe në ngjarjet që ndoqën këto zhvillime, përfaqësuesit kryesorë dhe këngët që bënë epokë.
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rëndësinë që ka muzika modern në jetën shoqërore. • krahason <i>zëra vokalë d.m.th këngëtarë, instrumentistë</i> të rrymave të ndryshme moderne. • krijon një cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer. • - performon këngën e parapëlqyer. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • - Moderne, • - xhaz, • - rok, • - bluz.
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • Teksti i nxënësit, • shembuj muzikor të parapërgatitura në Cd. • fragmente kryesore nga filma me jetën e këngëtarëve apo 		Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> • - Historia

instrumentistëve (Elvis Presli, Rei Çarls; Uitni Hjuston; Xhimi Hendriks etj.) në dvd.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në cd për dëgjim disa nga pjesët muzikore vokale ose instrumentale të luajtura apo kënduara nga njerëz të mëdhenj të kësaj muzike.

Nxënësit gjejnë kush janë dhe diskutojnë rreth muzikës që ata luajnë apo këndojnë. Ata ndërthurin njohuritë që kanë me kohën kur u zhvilluan këto stile muzikore, ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale.

Hapi I:I Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, kur mësuesi vendos në Cd këngë të ndryshme dhe fillon shpjegimin .

Hapi III: Ndërkohë diskuto, pyet dhe shpjegohet njëkohësisht duke plotësuar njohuritë që kanë vetë nxënësit lidhur me muzikën bluz, xhaz, rok etj. Si lindën këto lloj muzikash dhe pse u pëlqyen dhe u mirëpritën nga masat.

Rhythm & Blues

Muzika R&B (Rhythm and blues) është një lloj muzike shumë popullore, që gërsheton xhazin me muzikën bluz dhe u luan për herë të parë nga artistët amerikanë me ngjyrë. Në vitin 1947 kjo lloj muzike kishte hyrë tashmë në tregun muzikor, ndërsa emri me të cilin njihet dhe sot, iu vendos në vitin 1949. Deri në fund të viteve 1950, ajo qe bërë e famshme dhe shumë kompani regjistrimi disqesh kishin prodhuar mijëra albume me këtë lloj muzike.

Muzika Rock


Muzika rock është një lloj muzike e përcaktuar gjerësisht, që u zhvillua në vitet 1960, me rrënjët e veta nga muzika rock 'n' roll dhe rockabilly, të cilat në vetvete rrjedhin nga muzika rhythm and

blues, country dhe ndikime të tjera. Në shtesë të kësaj, muzika rock është influencuar edhe nga lloje të tjera muzike si muzika folk, jazz dhe ajo kasike.

Muzika Hip Hop, Rap

Hip Hopi është një kulturë që ka prejardhjen nga Nju Jork, DJ Afrika Bambataa ka bërë hapat e parë të kulturës së hip hop-it duke qenë MC, DJ, duke bërë “beatbox”. Së pari, hip hop-i ka filluar të krijohet nga DJ-ët të cilët kanë krijuar tingujt ritmik në dy pllaka. DJ Kool Herc është ai që ka pasur mjaft rëndësi në zhvillimin e hip hop-it. Në hip hop hyjnë : Dj-ët, reperët, grafitët, etj.. Duhet ditur që të bëhet dallimi mes hip hop-it dhe rap-it. Rap-i është pjesë përbërëse e hip hop-it, pra ai që bën muzikë rap themi se është përfshirë në hip hop. Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *youtube* apo *internet*, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.



Në këtë temë mësimore mund të bëjë lidhjen e njohurive muzikore që nxënësit duhet të marrin me njohuritë që ata kanë marrë nga lëndët e tjera në atë vit shkollor apo në vite të tjera. Ndërthurja e njohurive bëhet natyrshëm duke shpjeguar njohuritë e reja mbi muzikën moderne dhe zhanret e reja muzikore.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- N 2 - Shpjegimin e rëndësisë që ka muzika moderne në jetën shoqërore.
- N 3 - Krijimin e një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer.
- N 4 - Krahasimin e *zërave vokale d.m.th këngëtarë, instrumentistë* të rrymave të ndryshme moderne.
- N 4 - Performimin e këngës së parapëlqyer.

Detyra:

Krijim: Cd me këngë të ndryshme të këtyre rrymave dhe *materiale shoqëruese biografike.*

Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. *Punë individuale.*

Model ore mësimore 3 – Specialiteti- Piano, Dega e “Muzikës”AML

Fusha: Arte	Lënda: Piano (principale)	Klasa: X
Tematika: Pjesë e huaj - sonata		
Tema mësimore: L.V.Bethoven – Sonata e hënës Kohëzgjatja: 45 minuta		Situata e të nxënit: Njohje me veprën dhe kompozitorin – Video/regjistrim i veprës
Rezultatet e të nxënit sipas temës Nxënësi/ja në fund të kësaj ore është në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • deshifrojë partiturën e sonatës me fraza ritmikiisht dhe melodikiisht me të dyja duart; • luajë teknikisht në ritëm dhe dinamikë sonatën; • respektojë karakterin e veprës muzikore. 		Fjalë kyç: <ul style="list-style-type: none"> • Ritëm • Melodi • Harmoni • Frazë muzikore • Dinamika
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> • Partitura e nxënësit; • Video/regjistrim i veprës (përgatitur nga mësuesi) 		Lidhja me fushat/lëndët e tjera; - Solfezh
Fazat e realizimit të veprës: <ul style="list-style-type: none"> • Ora mësimore nis me prezantimin e veprës dhe kompozitorit të nxënësi/ja. • Kush ishte L.V. Bethoven? • Cili është tonaliteti dhe forma e veprës? • Çfarë karakteri ka vepra? • Cilat janë dinamikat e përdorura? • Cili është tempi përfundimtar? Dëgjimi i veprës: https://youtu.be/ClroHT-0bBE		

Ndërtimi i njohurive të reja:

Vendoset pjesa shqiptare për dëgjim (ose interpretohet nga vetë mësuesi) dhe ndiqen hapat e mëposhtëm:

- 1) deshifrim i partiturës me dorën e djathtë;
- 2) deshifrim i partiturës me dorën e majtë;
- 3) deshifrim i partiturës duar bashkë ngadalë;
- 4) ekzekutimi i partiturës nga fillimi në fund;
- 5) interpretimi i veprës në karakter.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

Niveli 2 - Deshifrimin e saktë të partiturës me të dyja duart.

Niveli 3 - Zbatimin e saktë të ritmit dhe dinamikave të veprës muzikore.

Niveli 4 - Interpretimin e veprës në karakter.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Praktikë individuale për realizimin e veprës.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore:

- mbështesin mësuesit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë, si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore për të gjykuar dhe për të vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore.

Zhvillimi i orës mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet dhe sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	<i>Niveli 1 - Dobët</i>	<i>Niveli 2 – Mjaftueshëm</i>	<i>Niveli 3 – Mirë</i>	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i>
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë komponentët e orës së mësimin në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të nxënës.	0 pikë <i>Nuk ka një koherencë mes komponentëve të orës mësimore. Rezultatet e nxënës (RN) nuk bazohen në programin</i>	1 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në</i>	2 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar</i>	3 pikë <i>Mësuesi ka planifikuar rezultatet e nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, cilën e ka përdorur si pjesë e metodologjisë së</i>

	<p><i>lëndor Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxënit. Pyetjet që janë planifikuar nuk janë të llojeve dhe të niveleve të ndryshme.</i></p>	<p><i>përmbushjen e rezultateve të të nxënit (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxënit. Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i></p>	<p><i>organizimin e nxënësve. Metodatat dhe teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxënit dhe me stilet e të nxënit. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i></p>	<p><i>mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxënit, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i></p>
<p>Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, përveç kompetencave lëndore.</p>	<p><i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.</i></p>	<p><i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së</i></p>	<p><i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK-ut dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet</i></p>

			shumti te metodave të konceptet planifikuara të lëndore, duke përfshijë edhe lënë mënjane rezultate të kompetencat kyç të nxënësve gjatë gjithë jetës.	metodave të planifikuara të përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të nxënësve gjatë gjithë jetës.
--	--	--	--	--

Mjedisi i të nxënësve (6 pikë)

Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri-tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	Mësuesi krijon një mjedis jo tradicional në klasë, por jo nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë mësuesit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.	Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.	Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.	Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxënësve për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit duke	Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë	Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku	Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të	Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe

i nxitur dhe motivuar të ndër marrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimi.</i>	<i>jo të gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndër marrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi pasivë. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndër marrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
---	--	--	--	---

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, dhe krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimi duke përqendruar</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimi, duke u përqendruar më së shumti vetëm te ato</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxitin mendimin kritik</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, ai përdor metoda dhe teknika që nxisin</i>
---	--	--	---	---

<p>mendimin ndryshe.</p>	<p>më së shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, mësimi përqendrohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</p>	<p>tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore, vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</p>	<p>dhe krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</p>	<p>mendimin kritik dhe krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe u jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</p>
<p>Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.</p>	<p>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe llojeve të niveleve të ndryshme Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm</p>	<p>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi por</p>	<p>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi, por nuk u jep</p>	<p>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimi.</p>

	<i>mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>nuk u jep mundësi mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	
--	--	---	---	--

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)

	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimi.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit.</i>
Mësuesi vlerëson për të identifikuar nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të nxënësit të orës mësimore.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënësit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin për të matur vetëm arritjet e nxënësit në orën e mësimi, duke identifikuar nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të</i>	<i>Mësuesi përdor vlerësimin për të identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi,</i>

			<i>nxënit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, por angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara, duke u bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nuk i angazhon</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore duke vënë edhe nxënësit në përdorim të tyre</i>

		<i>nxënit të temës mësimore.</i>	<i>shumë nxënësit në përdorimin e tyre.</i>	<i>në mënyrë që të nxisë te ata të mësuarin praktik dhe krijues.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore,</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale, por ato nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënit të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore, por nxënësit nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënësit në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënit të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktiv që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular nuk duhet të përmbajë njohuri të reja.*
- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të dy periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme



nga puna e secilit nxënës.

- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML

Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit

Tema e projektit: "Muzika në jetën e përditshme"

Kohëzgjatja: 6 orë, (të planifikuara 3 orë për çdo periudhë mësimore).

Klasa: 12-të

Rezultatet e të nxënësve: Në përfundim të projektit kurrikular nxënësi zbaton njohuritë dhe aftësitë muzikore, në jetën e tyre të përditshme dhe zhvillojnë një vlerësim më të thellë për muzikën në jetën e përditshme.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- intervista, anketa, kampionimi;
- grumbullimi i të dhënave;
- përpunimi i të dhënave;
- tabelat, diagramet,
- paraqitja grafike e të dhënave;
- interpretimi i të dhënave, prezantimi i tyre.

Partnerët: target e individëve që do të anketohen.

Burimet kryesore të informacionit: anketa, intervista, pyetësorë, materiale nga interneti


Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor:

- Përzgjedhja e temës, diskutimi
- Hulumtimi mbi temën
- Mbledhja e të dhënave
- Analiza e të dhënave
- Prezantimi i të dhënave
- Diskutim dhe Reflektim

Veprimtaritë kryesore sipas temave:

- Diskutoni me nxënësit rëndësinë e muzikës në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me vende dhe kontekste të ndryshme kulturore.
- Kërkojuni nxënësve të eksplorojnë nga evente apo ngjarje muzikore që ndodhin në jetën e përditshme.
- Kërkojuni nxënësve të identifikojnë dhe të mbledhin shembuj apo ndjesi nga jeta reale ku përdoret apo është luajtur muzika. Këto mund të përfshijnë situata në shtëpi, në shkollë, gjatë aktiviteteve të kohës së lirë ose në komunitet.
- Kërkojuni nxënësve të hulumtojnë dhe dokumentojnë këto ngjarje apo histori, duke shpjeguar se pse është e rëndësishme muzika, gjinitë muzikore, interpretuesit që ndeshni në evente apo ngjarje të ndryshme muzikore.
- Kërkojuni nxënësve të hetojnë se si njohuritë muzikore zbatohen në botën reale duke hulumtuar shembuj, duke kryer intervista, anketa ose duke analizuar ngjarje të ndryshme koncertore.
- Inkurajoni nxënësit të paraqesin në mënyrë vizuale/power point duke shpjeguar gjetjet e tyre, duke përfshirë shpjegimet e njohurive muzikore.
- Udhëzoni nxënësit në organizimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura duke përdorur një fjalor të duhur muzikor.
- Nxitni nxënësit të reflektojnë mbi kërkimet dhe përvojat e tyre gjatë gjithë projektit. Ata analizojnë rëndësinë e muzikës nga jeta reale dhe identifikojnë çdo sfidë ose keqkuptim që kanë hasur.
- Nxënësit përgatisin një prezantim përfundimtar për të ndarë gjetjet e projektit të tyre me klasën ose një audiencë më të gjerë, si prindërit ose nivelet e tjera të klasave.
- Lehtësoni diskutimet në klasë ku nxënësit mund të ndajnë gjetjet e tyre, të përfshihen në analiza kritike dhe të vlerësojnë efektivitetin e qasjeve të ndryshme për trajtimin e përdorimit të muzikës në jetën reale.
- Nxitni nxënësit të reflektojnë mbi të nxëniet e tyre, të marrin në konsideratë perspektiva alternative dhe të propozojnë strategji ose veprime shtesë.

Përshkrimi i produktit të projektit: Inkurajoni nxënësit të organizojnë një podium apo vitrina ku nxënësit të prezantojnë projektet e tyre para komunitetit të shkollës, duke ftuar prindërit, mësuesit dhe shokët e tyre të marrin pjesë. Inkurajoni nxënësit të përfshihen në diskutime dhe



t'u përgjigjen pyetjeve rreth projekteve të tyre, duke nxitur një kuptim dhe vlerësim më të thellë për muzikën në jetën e përditshme.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer mbi njohuritë dhe konceptet muzikore.
- ***Kuptimi muzikor:*** Zbatimi dhe shpjegimi i saktë i koncepteve muzikore në kontekste të jetës reale.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.

E. Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit

Tema e projektit: “Muzika gjatë periudhës së klasicizmit, përfaqësues dhe vepra”

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore:

Projekti do të zgjasë gjatë dy periudhave të realizuara në 6 orë mësimore në lëndën e Histori muzike, (3 orë për çdo periudhë).

Klasa/t pjesëmarrëse: Klasa e X-të.


Rezultatet e të nxënët

Në përfundim të projektit nxënësi:

- demonstroi njohuritë e marra për grumbullimin e të dhënave mbi muzikën klasike sipas kontekstit historik dhe kulturor të ngjarjeve;
- lexon dhe kupton të dhënat e grumbulluara mbi muzikën klasike;
- interpreton të dhënat dhe konsolidon njohuritë mbi ngjarjet, përfaqësuesit dhe veprat muzikore në periudhën e klasicizmit;
- dëgjon vepra muzikore dhe shpreh përjetimin e vet emocional, duke shpjeguar ndjesinë emocionale;
- përdor terminologjinë e duhur muzikore për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacionin dhe ndjesinë muzikore në vepra të ndryshme muzikore të krijuara gjatë periudhës së klasicizmit;
- bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shpjegimit të veprave muzikore por edhe të përfaqësuesve të tyre;
- prezanton para të tjerëve projektin për temën e dhënë, duke gërrshetur format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik;
- bashkëpunon me shokët për realizimin e projektit dhe kontribuon pozitivisht me grupin.

Konceptet kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

- a) dëgjimi i veprave, qëllimi i studimit;
- b) grumbullimi i informacionit dhe të dhënave;
- c) përpunimi i informacionit dhe të dhënave;
- d) paraqitja grafike e të dhënave;
- e) interpretimi i të dhënave, klasifikimi i veprave për prezantim;
- f) prezantimi i tyre.



Partnerët që do marrin pjesë në projekt: prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënës të shkollës, mësues etj.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim me nxënësit lidhur me përzgjedhjen e temës së projektit.
- Ndarja e klasës në grupe sipas dëshirës së nxënësve në bashkëpunim me mësuesen.
- Zgjedhja nga nxënësit e detyrës hulumtuese për secilin grup.
- Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.
- Hartimi i planit të veprimtarive për secilin grup.
- Kërkime njohurish të nevojshme në literaturën e rekomanduar, apo në internet në mënyrë që nxënësit të shfaqin aftësitë e tyre hulumtuese dhe studimore.
- Hartimi i pyetësorit (intervistave), përcaktimi i popullatës dhe përzgjedhja e kampionit në të cilën do të kryhet pyetësi (intervistat).
- Grumbullimi i informacionit nga pyetësorët, (intervistat), komunikimi me mësuesit, prindërit, anëtarë të komunitetit, nxënësit sipas popullatës së përzgjedhur.
- Përpunimi i të dhënave.

Burimet kryesore të informacionit:


- Informacioni i marrë nga interneti (kërkim mbi ngjarje, biografi dhe vepra muzikore);
- materiale audio nga interneti (you tube);

Baza materiale:

- Letra të bardha
- Kartonë
- Lapustila
- Cd
- Foto
- dvd etj.

Prezantimi i produktit sipas orëve të planifikuara:

Ora 1-2 -3. Përzgjedhja e temës së projektit. Ndarja e grupeve. Përcaktimi i detyrës hulumtuese për secilin grup. Ndarja e detyrave për secilin nxënës brenda grupit.



Hartimi i planit të veprimtarive të projektit brenda grupit përkatës, afatet dhe personi përgjegjës.

Ora 4-5-6. Përpunimi i materialit të grumbulluar, zhvillimi i të dhënave nga kërkime të ndryshme, ppt etj. Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. Prezantimi i materialit të përgatitur. Vlerësimi i punës në grup dhe individual i nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi për këtë projekt mund të bazohet në kritere, duke përfshirë:

- ***Aftësitë kërkimore/hulumtuese:*** Cilësia dhe thellësia e kërkimit të kryer mbi njohuritë dhe konceptet muzikore.
- ***Kuptimi i njohurive muzikore:*** Zbatimi dhe shpjegimi i saktë i koncepteve muzikore në kontekste të jetës reale.
- ***Aftësitë e prezantimit:*** Qartësia, organizimi dhe efektiviteti i prezantimit përfundimtar.
- ***Mendimi kritik dhe reflektimi:*** Thellësia e reflektimit mbi rëndësinë dhe sfidat e hasura gjatë projektit.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
Kriteret e vlerësimit	Niveli 1 – <i>Dobët</i>	Niveli 2 – <i>Mjaftueshëm</i>	Niveli 3 – <i>Mirë</i>	Niveli 4 – <i>Shumë mirë</i>
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme. Nxënësit përdorin një burim për të gjetur informacione.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave, fakteve, ngjarjeve etj.	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë përdorin teknika të përshtatshme.	Nxënësit ndonjëherë përdorin teknika të përshtatshme,	Nxënësit zakonisht përdorin teknika të	Nxënësit përdorin gjatë gjithë projektit teknika të përshtatshme dhe

<p>Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)</p>	<p><i>Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i></p>	<p><i>por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i></p>	<p><i>përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i></p>	<p><i>efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i></p>
<p>Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)</p>	<p>0-5 pikë</p> <p><i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri-tjetrin.</i></p> <p><i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i></p>	<p>6 -9 pikë</p> <p><i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre. Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i></p> <p><i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i></p>	<p>10-14 pikë</p> <p><i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i></p> <p><i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i></p>	<p>15-18 pikë</p> <p><i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i></p> <p><i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i></p>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

